



# Republika e Kosovës

## Republika Kosova - Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Data: 05.09.2016

Ref.: 798/16

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013, datë 16.01.2013), nenin 126 dhe 136 të Ligjit mbi Procedurën Administrative, nr. 02/L-28, datë 22.07.2005, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 44-të, të mbajtur më 25 Gusht 2016, mori:

### V E N D I M

I. Aprovohet pjesërisht kërkesa për rishqyrtim të vendimit nr. 452/16, datë 17.08.2016 e BPrAL Kolegjit "AAB".

II. Ndryshohet pika II e vendimit Ref.:651/16, datë 15.07.2016 sa i përket kohëzgjatjes së akreditimit të programeve të studimit. Kohëzgjatja e akreditimit për programet e cekura më poshtë ndryshohet si në vijim: Ri/akreditoohen programet e studimit për periudhën pesë vjeçare, 1 tetor 2016 – 30 shtator 2021:

- Psikologji, BA, 180 ECTS;
- Kulturë Fizike dhe Sport, BA, 240 ECTS;
- Kulturë Fizike dhe Sport, MA, 60 ECTS

III. Ndryshohet kuota e regjistrimit të studentëve të pika I e vendimit Ref.:651/16, datë 15.07.2016 për programin e studimit: Komunikim Masiv, BA, 180 ECTS (me specializime: Gazetari; Produksion) nga 90 student që ishte sipas vendimit të cekur më sipër në 160 student për vit akademik.

IV. Pjesa tjetër e vendimit të KSHC-së me Ref.:651/16, datë 15.07.2016 mbetet e pa ndryshuar.

V. Pika I, III, dhe V e kërkesës nr.452/16 dt. 17.08.2016 të parashtruar nga BPrAL Kolegji "AAB" refuzohen si të pabazuara, dhe me këtë rast KSHC la në fuqi vendimin me Ref.:651/16, datë 15.07.2016.

VI. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## Arsyetime

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) më datë 17.08.2016 ka pranuar kërkesë nga BPrAL Kolegji "AAB" për rishqyrtim të vendimit të Këshillit Shtetëror të Cilësisë (KSHC) Ref.:651/16, datë 15.07.2016. BPrAL Kolegji "AAB" përmes kërkesës për rishqyrtim të vendimit të parashtruar më 17.08.2016 ka kërkuar që të ndryshohet vendimi sipas kërkesës së BPrAL Kolegji "AAB".

KSHC ka shqyrtuar kërkesën BPrAL Kolegji "AAB" dhe ka vendosur të aprovoj pjesërisht kërkesën për rishqyrtim të datës 17.08.2016. Më këtë rast KSHC vendosi të ndryshoj kohëzgjatjen e akreditimit për tri programet e studimit nga 3 vite (1 tetor 2016 - 30 shtator 2019) sa ishte sipas vendimit të KSHC-së me Ref.:651/16, datë 15.07.2016, në pesë vite (1 tetor 2016 -30 shtator 2021) për programet e studimit: Psikologji, BA, 180 ECTS; Kulturë Fizike dhe Sport, BA, 240 ECTS; Kulturë Fizike dhe Sport, MA, 60 ECTS. Kjo pikë e kërkesës së parashtruar nga BPrAL Kolegji "AAB" u pranua si e bazuar nga KSHC, dhe pas shqyrtimit të dëshmimeve, KSHC erdhi në përfundim se nuk ka asnjë vërejtje serioze që këto programe të studimit të mos ri/akreditohen për periudhën pesë vjeçare. Për këtë arsye KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KSHC ka pranuar gjithashtu si të bazuar pikën IV të kërkesës për rishqyrtim të parashtruar nga BPrAL Kolegji "AAB" për ndryshimin e kuotës për regjistrim të studentëve në programin e studimit Komunikim Masiv, BA, 180 ECTS (me specializime: Gazetari; Produksion). Është konstatuar se gjatë caktimit të kuotave të studentëve është lëshuar një gabim teknik dhe me këtë rast KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sa i përket pikës I të kërkesës së parashtruar nga BPrAL Kolegji "AAB", KSHC vendosi të hedhë poshtë si të pa bazuar, dhe me këtë rast vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) përkatësisht Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) nuk ka caktuar kuota për student siç pretendohet në pikën I të kërkesës së BPrAL Kolegji "AAB". AKA mund të caktoj kuota vetëm në rastet kur ekspertët e akreditimit e rekomandojnë një gjë të tillë. Në rastin e BPrAL Kolegji "AAB" kuotat për studentë janë vendosur duke u bazuar në kërkesën dhe sqarimin e dhënë më shkrim (shkresa me nr. 400/16, datë 11.07.2016) nga BPrAL Kolegji "AAB" dhe janë në përputhje të plotë me shkresën e dorëzuar nga Kolegji "AAB", me përjashtim të gabimit teknik në programin Komunikim Masiv, BA, lëshim ky i cili është ndryshuar nga KSHC në pikën II të këtij vendimi.

Sa i përket pikës III të kërkesës së BPrAL Kolegji "AAB" për mos ri/akreditim të programit të studimit: Juridik - Civil, LLM, 60 ECTS, KSHC vendosi të hedhë poshtë si të pa bazuar kërkesën, dhe me këtë rast vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi. KSHC ka konstatuar se Kolegji "AAB" nuk ka sjellë ndonjë dëshmi e cila do të mund të merrej parasysh për të ndryshuar vendimin e KSHC-së. KSHC konsideron se gjendja faktike në kohën e vlerësimit të Kolegjit AAB është trajtuar me saktësi nga eksperti ndërkombëtarë i akreditimit dhe se argumentet e ekspertit për mos akreditimin e programit të studimit janë ofruar në Raportin Final të Ekspertëve të pranuar më datë 21.06.2016. Deklarimi nga Kolegji "AAB" se eksperti ndërkombëtarë i akreditimit nuk ka

marrë për bazë ndryshimet e bëra nga Kolegji AAB në fazën e komenteve të draft raportit të vlerësimit nuk qëndrojnë. Institucionet e arsimit të lartë mund të komentojnë në draft raportet e ekspertëve vetëm për gjendjen faktike të raportit, nëse pretendohet se faktet janë paraqitur ndryshe nga ato që institucioni i ka prezantuar. Institucionet e arsimit të lartë nuk mund të komentojnë në rekomandimet e ekspertëve ndërkombëtarë, dhe meqenëse ndryshimet të cilat janë kërkuar për tu bërë në kurrikulën e programit janë të mëdha, Ekipi i Ekspertëve nuk ka rekomanduar dhënien e ri/akreditimit për programin e studimit në fjalë.

Sa i përket pikës V të kërkesës së BPrAL Kolegji “AAB” për ndryshimin e kuotave për programin e studimit: Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS (me specializime: Inxhinieri Softverike; Telekomit dhe Rrjetat Kompjuterike; Mekatronika), KSHC vendosi ta refuzojë një kërkesë të tillë si të pa bazuar. Kuota e caktuar në vendimin e KSHC-së (Ref.:651/16, datë 15.07.2016) për programin në fjalë është vendos duke u bazuar në kërkesën për sqarim të dorëzuar nga BPrAL Kolegji “AAB” (shkresa me nr. 400/16, datë 11.07.2016). Pra kuota prej 200 studentëve për regjistrim në vit akademik për programin e studimit Shkenca Kompjuterike, BSc, 180 ECTS (me specializime: Inxhinieri Softverike; Telekomit dhe Rrjetat Kompjuterike; Mekatronika) nuk është caktuar nga AKA përkatësisht nga KSHC, por KSHC ka aprovuar kuotën të cilën BPrAL Kolegji “AAB” e ka specifikuar në kërkesën për sqarim (shkresa me nr. 400/16, datë 11.07.2016).

Duke u bazuar në dispozitat e cekura më lartë, dhe sqarimet e dhëna më sipër, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimit të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji “AAB”;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



---

Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha  
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë